

Tregtia me pakicë
shënon rritje në maj,
produktet ushqimore
me rritjen më të madhe



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

IKD: NGËRÇI POLITIK PO RREZIKON FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA



Mosfiksionimi i Kuvendit po pengon plotësimin e pozitive në institucionet dhe agjencitë e pavarura. Disa prej tyre tashmë janë jofunksionale

ose funksionojnë me përbërje të paplotë, ndërsa të tjera rrezikojnë të mbesin pa organet e nevojshme vendimmarrëse pas

përfundimit të mandateve aktuale. Kështu ka vlerësuar Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) duke analizuar situatën aktuale në vend

HAXHIU
NËNSHKRUAN
DEKRETET PËR
LIRIMIN NGA
DETYRA TË SHTATË
PROKURORËVE
SERBË

F. 7



MUJA NË ISTOG PAS DËMEVE NGA
BRESHRI: DO TË PROPOZOJMË MASA
PËR NDIHMË NDAJ BUJQVE

F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



PENTAGONI: GATI 100 USHTARË
AMERIKANË U PLAGOSËN NGA
SULMET E IRANIT

F. 2

ALEANCA ZGJEDH KRYESINË E RE,
AGIM ÇEKU NËNKRYETAR I SAJ

F. 5

NIS SHEMBJA E 11 SHTËPIVE PRANË
LIQENIT TË UJMANIT

F. 7

EKONOMI



GËRXXHALIU: BLOKIMI I HORMUZIT
DHE BAB EL-MANDEBIT DO TA
TRONDISTE EKONOMINË BOTËRORE

F. 8

SKEMA E SHITESAVE PËR FËMIJË
MBETET MË E MADHJA, MBI 401 MIJË
PËRFITUES NË QERSHOR

F. 8

SPORT



RENDITJA E RE E FIFA-S PAS
KUPËS SË BOTËS: SPANJA NGJITET
NË KRYE, MAROKU HYN
NË HISTORI

F. 10

PENTAGONI: GATI 100 USHTARË AMERIKANË U PLAGOSËN NGA SULMET E IRANIT

UASHINGTON, 21 KORRIK - Departamenti Amerikan i Mbrojtjes tha se dhjetëra ushtarë amerikanë janë plagosur nga sulmet e Iranit gjatë dy javëve të fundit. Zëdhënësi i Pentagonit, Sean Parnell, shkroi në platformën X më 20 korrik se gati 100 pjesëtarë të forcave të armatosura kanë pësuar një shkallë të caktuar lëndimi që nga 7 korriku. Ai shtoi se 96 për qind e tyre tashmë janë kthyer në detyrë dhe janë “të vendosur që të rikthehen në luftë”. Sipas Parnellit, “shumica” e lëndimeve kanë qenë tronditje të lehta të

trurit. Gjatë dhjetë ditëve të fundit Irani u është kundërpërgjigjur sulmeve ajrore amerikane në jug të vendit, duke lëshuar raketa drejt bazave ushtarake amerikane në disa shtete arabe të Gjirit Persik. Pasi tre ushtarë amerikanë u vranë në këto sulme, gazeta “The New York Times” publikoi më 20 korrik një raport, ku pretendohet se Pentagoni kishte “fshehur dhjetëra raste të ushtarëve amerikanë të plagosur” gjatë konfliktit me Iranin. Pak orë para publikimit të



shifrës së re të të plagosurve, Parnell i hodhi poshtë këto pretendime, duke i cilësuar

“të pabaza dhe keqdashëse”. Shtetet e Bashkuara thonë se synimi kryesor i

operacioneve është dobësimi në mënyrë sistematike i kapaciteteve detare dhe ushtarake të Iranit në zonën e Ngushticës së Hormuzit - një korridor jetik për transportin global të energjisë, të cilin Teherani e ka bllokuar në përgjigje ndaj luftës. Uashingtoni këmbëngul se sulmet drejtohen ndaj objektivave ushtarake që, sipas tij, përdoren për ta kërcënuar lundrimin në Ngushticë. Por, përplasjet kanë shtuar frikën për një konflikt më të gjerë në Lindjen e Mesme.

LUFTA PARALIZON JUGUN E IRANIT: ERRËSIRË, MUNGESË KARBURANTESH DHE VARKA TË SHKATËRRUARA

TEHERAN, 21 KORRIK - Disa fajësojnë Teheranin. Të tjerë Uashingtonin. Por, gati të gjithë banorët e bregdetit jugor të Iranit bien dakord për një gjë: rikthimi i sulmeve ajrore mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit i ka goditur rëndë, duke i lënë pa energji elektrike, pa karburante dhe pa mundësi për të siguruar jetesën.

Në brigjet e provincave Khuzestan dhe Bushehr përgjatë Gjirit Persik, si dhe në bregdetin Makran në provincën Hormozgan, buzë Detit të Omanit, jeta ka qenë gjithmonë e lidhur me detin.

Sulmet e fundit nga Shtetet e Bashkuara - që Uashingtoni thotë se janë nxitur nga sulmet e Iranit ndaj anijeve tregtare në dhe përreth Ngushticës së Hormuzit - kanë goditur porte, anije dhe varka peshkimi, duke përmbysur jetën e peshkatarëve, detarëve dhe të gjithë atyre që varen nga tregtia detare.

“Shumë varka janë fundosur, janë goditur nga raketat”, thotë një banor i jugut të Iranit në një video të shpërndarë në rrjetet sociale. “Shumë varka u dogjën... Harrojini paratë, mendoni sa jetë njerëzish janë humbur”.

Autoritetet iraniane thonë se bombardimet kanë vrarë rreth 50 persona, përfshirë civilë, që kur ShBA-ja ka nisur sulmet në jug të Iranit në fund të qershorit.

Gjatë nëntë ditëve të fundit sulmet janë bërë të përditshme. Shtetet e Bashkuara thonë se qëllimi kryesor është dobësimi sistematik i kapaciteteve detare dhe ushtarake të Iranit në zonën e Ngushticës së Hormuzit - një korridor jetik për transportin global të



energjisë, të cilin Irani e ka bllokuar si përgjigje ndaj luftës. Uashingtoni këmbëngul se sulmet kanë në shënjestër objektivat ushtarake që, sipas tij, përdoren për ta kërcënuar lundrimin në Ngushticë. Por, banorët thonë se pasojat ndihen shumë më thellë në jetën e përditshme. Sulmet ndaj termocentraleve dhe nënstacioneve të transmetimit përgjatë bregdetit kanë lënë pa energji sistemet e ftohjes në një rajon ku temperaturat në korrik shpesh i kalojnë 40 gradë celsius. Në qytetin port Bandar Abas, një banor tregoi se është detyruar të rrinte me familjen në makinë, pasi shtëpia e tyre kishte mbetur pa energji elektrike. “Nuk kemi rrymë. Natën, kur duam të flemë, dëgjojmë vetëm luftën dhe shpërthimet... Çfarë kemi bërë që ta meritojmë këtë? Të rrimë në mesditë në makinë me gjithë familjen, në vend që të

pushojmë në shtëpi? Në 41 gradë, pa rrymë, thjesht zien nga vapa”, tha ai.

Në provincën e pasur me naftë të Khuzestanit, banorët thonë se ka ndërprerje të vazhdueshme të energjisë, që e bëjnë edhe më të vështirë valën ekstreme të të nxehtit. “Po e ndërpresin rrymën në këtë vapë”, tha një banor, duke iu referuar qyteteve Abadan, Khorramshahr dhe pjesës tjetër të provincës. “Është e padurueshme”.

Rrugët dhe urat e dëmtuara e kanë përkeqësuar edhe më krizën, duke bllokuar hyrje-daljet nga qytetet bregdetare. Në rrjetet sociale, shoferët u bëjnë thirrje njerëzve t'i shmangin udhëtimet me makinë. Radhët e gjata për karburante janë bërë pjesë e përditshmërisë, ndërsa ndërprerjet e energjisë kanë prekur edhe rrjetet e komunikimit, duke lënë

shumë familje, për orë të tëra, pa mundur të marrin vesh nëse të afërmit e tyre në zonat e goditura janë të sigurt. Megjithatë sulmet amerikane janë kryer në pjesë të ndryshme të Iranit, fokusi kryesor ka qenë bregdeti jugor, ku mijëra mjete lundruese kanë mbetur të bllokuara në Gjirin Persik, për shkak të luftës.

Të dyja palët fajësojnë njëra-tjetrën për dështimin e memorandumit të mirëkuptimit, të nënshkruar muajin e kaluar, i cili ka ndaluar luftimet, për të hapur një periudhë 60-ditore bisedimesh për zgjidhjen e konfliktit që shpërtheu më 28 shkurt. Situata është bërë aq e rëndë, sa javën e kaluar dhjetëra mijëra iraniane nënshkruan një peticion online, duke u kërkuar udhëheqësve të linjës së ashpër që ta vizitojnë jugun e vendit dhe t'i shohin vetë kushtet, në vend që të marrin

vendime nga larg që, sipas tyre, rrezikojnë jetën e qytetarëve të zakonshëm. “Një veprim i tillë mund të sjellë më shumë ndjeshmëri, mbështetje më efektive dhe vendimmarrje më reale në nivel kombëtar”, thuhet në peticion.

Të tjerë, të zhgënjyer nga rikthimi i luftës, thonë se edhe Uashingtoni mban përgjegjësi për rifillimin e luftimeve.

Një banor e përshkroi situatën si një fushatë bombardimesh “që nuk na lë të flemë”.

Konflikti ka goditur rëndë edhe turizmin.

Megjithatë monumentet historike në Khuzestan dhe në ishullin Keshm nuk janë dëmtuar drejtpërdrejt, zonat bregdetare janë kthyer në zona sigurie, duke zbratur bujtinat dhe duke lënë pa punë guidat turistike, pikërisht para sezonit kur zakonisht rajoni pret më shumë vizitorë.

Në Keshm dhe Sirik, varkat e djegura kanë marrë me vete jo vetëm burimin e jetesës së peshkatarëve, por edhe një pjesë të trashëgimisë detare të jugut të Iranit.

Por, mes shkatërrimit, banorët flasin edhe për solidaritetin e njerëzve në pjesë të tjera të Iranit, të cilët kanë hapur dyert e shtëpive për familjet e zhvendosura nga zonat më të goditura.

Për shumë banorë të Gjirit Persik, pikërisht kjo ndjenjë solidariteti - po aq sa shpresa për fundin e luftës - është ajo që i ndihmon të vazhdojnë. “Gjëja e parë që kontrollojmë është nëse jemi ende gjallë, nëse fqinji ynë është gjallë dhe nëse kemi ende pranë miq dhe familjarë”, tha një banore e jugut të Iranit.

RRUGA DREJT THEQAFJES!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Autoritarizmi “demokratik”: LV-ja në me krye pronarin e saj Albin Kurthi, KM në detyrë me më shumë pushtet dhe fuqi se të gjithë kryeministrat e rregullt që nga përfundimi i luftës, po e shkruan ligjin dhe Kushtetutën ashtu si ia do qejfi! Nuk ka ligj apo Kushtetutë që i bindet nëse vetëm pak ia prekë pushtetin. Kapë çka të dojë, emëron kënd të dojë, shkarkon kënd të dojë ndërsa buxhetin e Kosovës e konsideron kuletë personale apo para xhepi. Nuk ka lënë komandant lufte, ushtarë të UÇK-së apo politikanë me të kaluar të luftës që nuk i ka sulmuar, si individë apo familjet e tyre duke i fyer dhe duke i quajtur hajna të korruptuar, tregtarë me toka shqiptare dhe tradhtarë të çështjes kombëtare. Plotë 20 vjet ka shpërndarë urrejtje dhe helm për të ardhur në pushtet. Dhe erdhi në pushtet! Tash përçarjen dhe urrejtjen ndaj çdo gjëje që ndërlidhet me luftën e UÇK-së dhe çështjen kombëtare e përdorë për të qëndruar në pushtet. Nuk ka zgjedhur mjete për kapje të pushtetit dhe nuk po zgjedhë mjete që këto kapje t'i shndërrojë në kategori kushtetuese të Kushtetutës së LV-së, meqë Kushtetuta e Kosovës për ta është rregullore e punës së Kosovapetrollit që e ka flamurin lara - lara e që ka rastisë të jetë edhe flamur zyrtar i Republikës së Kosovës. Albin Kurthi kërkoi 80 deputetë për ta përligjur diktaturën si qeverisje demokratike dhe për ta zgjedhur presidentin sipas formatit të bajrambegajt në Shqipëri apo, siç ka thënë Kurthi se i duhet një president nga shoqata e zjarrfikësve që do ta shuaj zjarrin në pronën e Fitore Pacollit në Marec e jo dikush që merret me politikë! Këto janë kriteret e Kurthit! Prandaj e provoi me Feriden, prandaj mund të vazhdojë me Feriden. Kurthi tha botërisht se i ka votat për Kuvend dhe qeveri që është shumë e vërtetë dhe se opozita i duhet vetëm për ta zgjedhur presidentin. Pastaj është ajo: “kalova lumin, ta q...a kalin”. Po të donte Kurthi bashkëpunim me opozitën, mënyra më e mirë do të ishte të thërrasë në



një takim partitë opozitare me ç’rast do t’i informonte se LV-ja e njeh të drejtën e pakushtëzuar opozitës ta propozojë një emër për president, politik apo jopolitik, nuk ka rëndësi dhe se do të merrte votat e LV-së. Në këtë mënyrë LV-ja dhe Albin Kurthi, si padre padrino i saj do ta sillte opozitën në një situatë të sikletshme shkaku se opozita nuk do të merrej vesh asnjëherë për një kandidat të përbashkët andaj fajësia do të adresohet te opozita. Kurthi luftën kryesore e ka fajësimin e opozitës për dështim të zgjedhjes së presidentit ndonëse përgjegjësia dhe mundësia është 100 për qind e LV-së. Opozita është e pafuqishme përballë pushtetit shkaku i numrave dhe përçarjes së thellë që e kanë. Po të kishte Kosova një opozitë në këmbë, me vullnet për opozitbërje, LV-së duhet t’ia votojë çdo kandidat që e propozon dhe 5 minuta pas

votimit do të fillonte me protesta të pandërprera deri sa pozita të mbledhë mend dhe të punojë për të mirën e qytetarëve dhe shtetit. LV-ja do zgjedhje dhe qeverisjen anarkike përmes riciklimit të krizave. Pa kontroll parlamentare, në errësirë totale, pa llogaridhënie, Kosova është shndërruar në plaçkë të LV-së, injorantëve, mediokërve antishtet dhe antikombëtarë që kanë metastazuar në të gjitha shtresat institucionale. Kurthi e ka të sigurt se me këtë opozitë të vdekur klinikisht, me një infuzion 400 milionë euro para zgjedhjeve, mund të blejë vota sa të dojë prandaj provokon zgjedhje pas zgjedhjeve. Aktualisht Kurthin mund ta rrëzojë vet Kurthi dhe protestat e përditshme derisa të krijohet masa kritike. Opozita po gabon kur mendon se gazi amerikan do të shndërrohet në kuti votimi për opozitën dhe ndëshkim

për pozitën. Në fund Kurthi do ta pranojë gazin amerikan dhe opozita do të mbetet me gishta në gojë. Opozita po e luan lojën e Kurthit prandaj jemi ku jemi!

Lenka Quko alias Lenka Haxhiu: Edhe sikur Lenka Haxhiu ta kishte zënë peshkun e artë i cili do t’i përmbushte çdo dëshirë në këmbim të lirisë, Lenka Haxhiu nuk do të dinte të kërkonte nga peshku i artë pozitën që i mbanë sot dhe ato që i kishte dje. Aq shumë ka rënë përtokë morali, aq shumë ka degraduar integriteti profesional, aq po lartësohet injoranca dhe mediokriteti, aq lartë dhe aq fuqishëm po valvitet flamuri i patriotizmit të rremë. Si sinjalizuese dhe denoncuese, Lenka Haxhiu e paraqiti rastin e Zejnullah Gashit, k.prokuror i Prokurorisë Themelore, si përpjekje për ushtrim ndikimi, ndërkaq tani si bartëse e posteve që ia ka caktuar Kurthi, pa u bërë 24 orë nga paraqitja e kërkesës së KPK-së, e dekretoi Zejnullah Gashin kryeprokuror të shtetit. Çfarë dyfytirësie dhe mungesë elementare të moralit! Një ndër argumentet për ekspresdekretim ishte se këtë e paska kërkuar shoqëria civile. E njëjta shoqëri civile për çdo ditë kërkon nga Lenka Haxhiu që me urgjencë ta thërrasë mbledhjen e seancës për votimin e legjislaturës së radhës së Kuvendit të Kosovës. Këtë kërkesë Lenka Haxhiu e shpërfillë deri në ditët e fundit të afatit kushtetues. Kur nuk ka qare pa e thirrë seancën! Me terma mjekësorë, thirrja e seancës konstituive të Kuvendit është çështje e ngutshme ndërsa dekretimi i kryeprokurorit është “operacion i ftohët”, që mund të presë një kohë, së paku deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë vendim për rastin e ish-kryeprokurorit të shtetit Blerim Isufaj, brutalisht i pushkatuar nga Kurthi dhe paramilitarët e LV-së. Çfarë shteti!

Gjithçka është e kalbur në shtetin e Kosovës: Po e keqpërdori një thënie të Shekspirit si nëntitull por në vend të Kosovës duhet të jetë Danimarka. Qytetarët e

Kosovës po e presin vendimin e Gjykatës Speciale Raciste me ndjenja të përziëra, patriotët dhe kombëtarët me shpresë se do të lirohen kurse pushteti dhe LV-ja me shpresë se do të dënohen. Jam i sigurt se GJSR tashmë e ka një vendim, po e bëjnë gati arsyetimin. I tërë procesi është paragjykuar duke dhunuar brutalisht nga kjo Gjykatë parimi i prezumimit të pafajësisë. Nuk ka Gjykatë në historinë e njerëzimit që aq shumë ka abuzuar dhe që ka masakruar me ligjin dhe të burgosurit se kjo, që nga koha e Hamurabit dhe Prokrustit e deri më sot. Dhe nuk ka pasur dhe nuk ka pushtet që nuk i ka mbrojtur interesat e Gjykatës dhe që ka dëmtuar shtetasit e saj se që e bënë pushteti aktual i përfaqësuar nga Albin Kurthi, Xhelal Sfeqla, Albulena Haxhiu, Donika Shvarc, Glauk Konjufca, si ajka kombëtare e Bangladeshit e mos të flasë për zagarët e saj në Londër, Oslo, Nju Jork, Beograd me degën e saj aktive në Prishtinë. Në fund të maratonës së një krimi të paparë juridik të “drejtësisë” ndërkombëtare kundër udhëheqësve të luftës së UÇK-së, shpallësve të pavarësisë dhe ndërtuesve të Kosovës nga hiri, çojen jepen deklarata të panevojshme dhe të pamatura. Dikush po thotë se e kallim Kosovën më kohën kur Gjykata është në Hagë, nipi politik i Arkanit në Prishtinë e mbron Gjykatën, dikush kërkon që Hashim Thaçi të propozohet president (kur ai ishte marrë peng pikërisht si president i Kosovës), dikush thotë se PDK-ja duhet ta votojë çdo propozim të LV-së për president me kusht që LV-ja ta shpërbëjë Gjykatën Speciale Raciste. Kjo është sikur të kërkonte nga Pont Pilati ta falë Krishtin apo të kërkonte nga Juda besnikëri ndaj Krishtit. Qeveria aktuale jo që nuk e shpërbënë GJSR por, përkundrazi është e vullnetshme ta formojë një Gjykatë tjetër që, në rast se GJSR nuk e shqipton dënimin e prituri dhe të dëshiruar, Gjykata tjetër e jep dënimin e prituri, të dëshiruar dhe të kërkuar. Kjo ishte kërkuar botërisht në Kuvendin e Kosovës, apo e kam gabim. Të poshtër dhe të pafytyrë!

Selimi parashikon koalicionin LV-LDK: Konjufca president, Abdixhiku zëvendëskryeministër, Osmani kryetare e Kuvendit

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ish-ministri i Jashtëm, Petrit Selimi, ka publikuar një skenar të mundshëm për arrijtjen e një marrëveshjeje politike në mes të LV-së dhe LDK-së për formimin

e institucioneve të reja në Kosovë. Në rrjetin X, Selimi ka shkruar se Glauk Konjufca mund të jetë kandidat për president nëse LDK-ja hyn në koalicion, ndërsa

Vjosa Osmani mund ta marrë pozitën e kryetares së Kuvendit. Ai ka shtuar se Lumir Abdixhiku mund të jetë zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm, duke

përmendur se realizimi i këtij skenari varet edhe nga pjesëmarrja e AAK-së në seancë si dhe nga pranimi nga Albin Kurti i projektit për gazpërçuesin amerikan të LNG-së.





IKD: NGËRÇI POLITIK PO RREZIKON FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

Mosfunksionimi i Kuvendit po pengon plotësimin e pozitave në institucionet dhe agjencitë e pavarura. Disa prej tyre tashmë janë jofunksionale ose funksionojnë me përbërje të paplotë, ndërsa të tjera rrezikojnë të mbesin pa organet e nevojshme vendimmarrëse pas përfundimit të mandateve aktuale. Kështu ka vlerësuar Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) duke analizuar situatën aktuale në vend

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 21 KORRIK - Një numër i madh i institucioneve dhe agjencive të pavarura vazhdojnë të funksionojnë me pozita të paplotësuara, mandate të skaduar ose me procedura të papërfunduara për zgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve dhe anëtarëve të tyre. Në disa raste mungesa e emërimeve ka lënë disa prej këtyre institucioneve pa përbërje të plotë, ndërsa pozita të caktuara vazhdojnë të jenë të zbrazëta prej vitesh. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka analizuar gjendjen e mandateve dhe pozitave të lira në institucionet dhe agjencitë e pavarura. Sipas IKD-së, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i pozitave vazhdojnë të mbeten të paplotësuara, ndërsa për mandate që kanë përfunduar ose janë në prag të përfundimit

duhet të zhvillohen procedurat përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen ndërprerje në funksionimin e këtyre institucioneve. "Gjendja është veçanërisht shqetësuese në institucionet ku mungojnë shumica apo të gjithë anëtarët e organeve përkatëse. Këshilli Kombëtar i Shkencës duhet të plotësohet me të 15 anëtarët, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me 11 anëtarë, ndërsa Komisioni për Ndihmë Shtetërore vazhdon me mandate të përfunduara që nga marsi i vitit 2022. Komisioni për Verifikimin dhe Vendosjen për Prona është pa përbërje, kurse Bordi i Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media duhet të plotësohet me të tre anëtarët", thuhet në komunikatën e IKD-së.

Sipas kësaj analize të IKD-së, pozita të paplotësuara vazhdojnë të ketë edhe në dy

institucione kushtetuese. "Gjykata Kushtetuese duhet të plotësohet me dy gjyqtarë, ndërsa Këshilli Gjyqësor i Kosovës vazhdon me një pozitë të paplotësuar. Pozita të rëndësishme drejtuese vazhdojnë po ashtu të mbeten të paplotësuara. Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të plotësohet me Avokatin e Popullit dhe katër zëvendësavokatë. Mandati i Avokatit të Popullit ka përfunduar më 28 shtator 2025, ndërsa mandatet e katër zëvendësve kanë përfunduar më 14 qershor 2025. Ligji kërkon që procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të fillojë gjashtë muaj para përfundimit të mandatit, ndërsa Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij vazhdojnë ushtrimin e funksionit deri në zgjedhjen e pasardhësve të tyre", thekson IKD, duke shtuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit vazhdon

pa kryetar të Bordit pas dorëheqjes së tij në gusht 2024, ndërsa Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të plotësojë pozitën e kryesuesit, mandati i të cilit ka përfunduar në nëntor 2023. "Edhe Komisioni Shqyrtues i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit vazhdon pa kryesues pas përfundimit të mandatit në qershor 2024. Probleme me plotësimin e përbërjes vazhdojnë edhe në institucione të tjera të rëndësishme. Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare duhet të plotësohet me pesë anëtarë të Bordit, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave me katër anëtarë, Bordi i KOSTT-it me tre anëtarë dhe Autoriteti i Pavarur i Konkurrencës me dy anëtarë. Pozita të lira ka edhe në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Bordin Mbikëqyrës dhe Komisionin për Verifikimin dhe Vendosjen për Prona të Agjencisë Kosovare të Pronës", ka vlerësuar IKD. Sipas kësaj organizate, në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2026 kanë përfunduar ose

përfundojnë mandatet e drejtuesve të disa institucioneve të rëndësishme. Mandati i komisionares së Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka përfunduar më 17 qershor 2026. Në përputhje me ligjin, komisionarja vazhdon ushtrimin e funksionit deri në zgjedhjen e pasardhësit të saj. Mandati i drejtorit të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit përfundon gjatë muajit korrik 2026, ndërsa në gusht 2026 përfundojnë mandatet e kryesuesit dhe dy anëtarëve të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Po ashtu, mandati i Auditorit të Përgjithshëm përfundon më 12 gusht 2026. "Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm vazhdon ushtrimin e funksionit deri në zgjedhjen e pasardhësit, ndërsa procedura për zgjedhjen e Auditorit të ri duhet të zhvillohet me kohë për të shmangur zvarritjet në këtë institucion kushtetues. Mandati i drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit përfundon më 24 dhjetor 2026. Procedura për zgjedhjen e drejtorit të ri duhet të iniciohet para përfundimit të mandatit. Drejtori aktual vazhdon

DEPUTETI I LV-së, QORROLLI: DUAM NJË MARRËVESHJE POLITIKE ME LDK-në PËR TË GJITHA INSTITUCIONET

PRISHTINË, 21 KORRIK - Deputeti i LV-së, Vigan Qorrolli, tha se synimi i partisë është të arrijë një marrëveshje politike me LDK-në për formimin e institucioneve të reja, përfshirë edhe zgjedhjen e presidentit. Sipas tij, po presin që LDK-ja t'i zgjidhë çështjet e brendshme lidhur me kërkesën për shkarkimin e Lumir Abdixhikut, në mënyrë që të vazhdojnë bisedimet.

Në një bisedë për RTV21, deputeti Qorrolli tha se u. d. presidentja Haxhiu pritet ta thërrasë seancën për konstituimin e Kuvendit jo më vonë se deri më 5 gusht. "Ne jemi në pritje që të thirret seanca konstituive. Afati i fundit është 7 gushti dhe besojmë se jo më vonë se 5 gushti do të thirret seanca konstituive. Besoj se gjatë kësaj jave znj. Haxhiu do ta nxjerrë dekretin për thirrjen e seancës konstituive. Kanë mbetur edhe tri javë në mënyrë që LDK-ja të arrijë një konsensus të brendshëm. Ne duam dhe e kemi bërë të qartë se duam një marrëveshje politike për të gjitha institucionet. Kjo ka qenë edhe kërkesa e LDK-së. Në muajt mars dhe prill, LDK-ja



kërkonte një marrëveshje klasike politike. Negociatat kanë qenë në rrugë të duhur për të arritur një marrëveshje të tillë politike, në mënyrë që të hyhet në seancë, të zgjidhet kryetari i Kuvendit, kryeministri Kurti të rikonfirmohet në detyrë dhe më pas të zgjidhet edhe çështja e

presidentit, duke i dhënë Kosovës institucione stabile", tha Qorrolli.

Deputeti Qorrolli tha se vendi mund të shkojë në zgjedhje nëse partitë politike nuk arrijnë një marrëveshje nga e cila do të propozohet një kandidat jopartiak për president. "Nëse

nuk arrihet kompromis për një emër të veçantë, që do t'i kënaqte të gjitha partitë politike, pra për një emër konsensual, natyrisht zgjedhjet mund të duken të pashmangshme. Por ne nuk duam zgjedhje, sepse nuk është zgjidhja më e mirë. Në rast se

partitë nuk bien dakord për një emër konsensual, në gjykimin tonë, në këtë moment mendojmë se figura e presidentit duhet të jetë jopartiake, një figurë mbi palët politike. Atëherë vendi mund të shkojë në zgjedhje, por jo me dëshirën tonë", u shpreh ai.

Aleanca zgjedh Kryesinë e re, Agim Çeku nënkryetar i saj

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka njoftuar se Këshilli i Përgjithshëm i partisë, i dalë pas zgjedhjeve të brendshme, ka votuar përbërjen e re të Kryesisë dhe ka funksionalizuar organet kryesore të Aleancës. Sipas Gjinit, janë themeluar dhe funksionalizuar Këshilli i Kryetarëve të Degëve, Këshilli i Nderit, Kolegjiumi i Ekspertëve të Aleancës, Kolegjiumi i Anëtarëve të Kuvendeve Komunale dhe Kolegjiumi i

Drejtorëve të Aleancës.

Ai theksoi se ky proces përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e strukturave të partisë dhe në përgatitjen për sfidat politike që e presin Aleancën.

Gjini shtoi se Kryesia e re përfaqëson një ndërthurje të përvojës dhe energjisë së re, me synimin për të udhëhequr me përgjegjësi proceset politike dhe organizative të partisë.

Në fund ai i uroi të gjithë të zgjedhurit për detyrat e reja,

duke theksuar se AAK-ja mbetet e përkushtuar për një Kosovë më të zhvilluar, më të sigurt dhe më të fuqishme. Ish-kryeministri dhe ish-komandanti i UÇK-së, Agim Çeku, është zgjedhur nënkryetar i Aleancës, në kuadër të përbërjes së re të Kryesisë së partisë. Krahas Çekut, nënkryetarë u zgjedhën edhe Besnik Tahiri, Burim Ramadani, Time Kadrijaj dhe Smajl Latifi, ndërkaq Avni Arifi është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i Aleancës.



ushtrimin e funksionit deri në zgjedhjen e pasardhësit", thuhet në këtë komunikatë.

IKD-ja vlerëson se mosplotësimi me kohë i pozitave në institucionet dhe agjencitë e pavarura nuk mund të trajtohet vetëm si çështje administrative. "Mungesa e drejtuesve, anëtarëve dhe përbërjeve të plota rrezikon vendimmarrjen, funksionimin institucional, ushtrimin e kompetencave ligjore dhe mbikëqyrjen efektive në fusha të rëndësishme për qytetarët. Situata aktuale nuk është rezultat i një rasti të izoluar, por pasojë e një krize të zgjatuar institucionale dhe politike. Që nga zgjedhjet parlamentare të 9

shkurtit 2025, Kosova nuk ka arritur të krijojë stabilitet të institucioneve. Mosarritja e shumicës parlamentare pas zgjedhjeve të rregullta çoi në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit 2025, ndërsa dështimi për zgjedhjen e Presidentit të Republikës solli shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të 7 qershorit 2026. Edhe pse rezultatet e këtyre zgjedhjeve janë certifikuar më 8 korrik 2026, Kuvendi ende nuk është konstituuar, ndërsa vendi vazhdon të qeveriset nga një Qeveri në detyrë", ka theksuar IKD.

Sipas IKD-së, kjo gjendje ka lënë pezull një numër të madh

procedurash për emërimin e drejtuesve dhe anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura, të cilat, sipas Kushtetutës dhe ligjeve, varen nga veprimi i Kuvendit ose nga bashkëveprimi ndërmjet Kuvendit dhe qeverisë. "Sa më gjatë të zgjasë moskonstituimi i Kuvendit, aq më shumë rritet numri i institucioneve që funksionojnë me mandate të skaduara, me përbërje të paplotë ose me pozita kyçe të paplotësuar. Megjithatë, kriza politike nuk mund të shërbejë si shpjegim për të gjitha vonesat. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre procedurave është dashur të ishin iniciuar muaj para

përfundimit të mandateve, ashtu siç kërkon legjislacioni në fuqi. Mosrespektimi sistematik i këtyre afateve ka bërë që vonesat të grumbullohen nga një legjislaturë në tjetrën, duke krijuar një zinxhir të mosveprimit të institucioneve që sot reflektohet në numrin e madh të pozitave të paplotësuar", thuhet në komunikatën për medie.

IKD-ja i bën thirrje Kuvendit që, menjëherë pas konstituimit të tij dhe qeverisë, në përputhje me kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore, të trajtojë si prioritet absolut përfundimin e procedurave të emërimit në institucionet dhe

agjencitë e pavarura. "Këto procedura duhet të zhvillohen pa vonesa të mëtejshme, në mënyrë transparente, mbi bazën e meritës, integritetit profesional dhe respektimit të afateve të përcaktuara me ligj. Institucionet e pavarura janë krijuar për të garantuar kushtetutshmërinë, ligjshmërinë, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, konkurrencën, mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike. Ato nuk duhet të mbeten peng i krizave politike dhe i mosveprimit institucional. Çdo vonesë në plotësimin e tyre është një vonesë në funksionimin e shtetit", theksohet në komunikatën e IKD-së.

RUSINOVCI: KOSOVA DUHET TË KRIJOJË FOND PËR KOMPENSIMIN E FERMERËVE TË DËMTUAR NGA FATKEQËSITË NATYRORE

PRISHTINË, 21 KORRIK - Profesori universitar dhe eksperti i bujqësisë, Imer Rusinovci, ka kërkuar krijimin e një fondi të veçantë për kompensimin e fermerëve që pësojnë dëme nga fatkeqësitë natyrore pas dëmeve të shkaktuara nga breshri të hënën në disa zona të Kosovës.

Rusinovci në një intervistë për "Ekonomia Online" tha se breshri rënë ditët e fundit ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në regjionin e Istogut dhe në disa fshatra të Skenderajt, ndërsa dëme më të vogla janë evidentuar edhe në komunat e Lipjanit dhe Ferizajt. Ai tha se fillimisht duhet të bëhet vlerësimi profesional i dëmeve nga komisionet në nivel lokal, në koordinim me nivelin rajonal dhe qendror, në

mënyrë që fermerët e prekur të mund të kompensohen. "Po realisht në bujqësi ndodhin edhe të tilla fatkeqësi natyrore që i quajmë ne, siç është breshri që ishte konkretisht dje në regjionin e komunës së Istogut me shumë fshatra përreth, në regjionin e Skenderajt, me disa fshatra po ashtu me dëme të konsiderueshme. U evidentuan disa dëme të vogla në raport me Istogun janë më të vogla në komunën e Lipjanit dhe të Ferizajt. Por këto dëme normal që janë të konsiderueshme dhe fjalën përfundimtare mund ta thonë komisionet profesionale që ngrihen në nivel lokal, në koordinim të plotë me nivelin rajonal dhe nivelin qendror. Përdërisa nuk ka një raport të vlerësimit, sepse nuk bëhet fjalë për hulumtim të mirëfilltë aty,

por për një vlerësim se sa është shkalla e dëmeve që mund të jetë, do të thotë, e përshkallëzuar 20, 30, 50, 80, 90% e kështu me radhë, varësisht prej intensitetit të breshrit që ka rënë, atëherë raporti i tillë duhet të përcillet, domethënë, i koordinuar deri në nivel qendror, që të paktën presim një kompensim për fermerët që janë atakuar nga këto fatkeqësi natyrore, konkretisht nga breshri", tha ai. Eksperti i bujqësisë paralajmëroi se ndryshimet klimatike po sjellin çrregullime në balancën mes reshjeve dhe temperaturave, duke e bërë bujqësinë gjithnjë e më të ekspozuar ndaj kushteve ekstreme atmosferike. Rusinovci tha se Kosovës i mungon një fond i veçantë për



përballimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, duke përmendur krahas breshrit edhe thatësitë, zjarret, tërmetet dhe përmytjet. Ai kërkoi që institucionet përgjegjëse t'i autorizojnë komunat për të dalë në terren dhe t'i

evidentojnë dëmet në secilën parcelë të prekur. Rusinovci ka ngritur edhe çështjen e mbrojtjes nga breshri përmes sistemeve kundër breshrit, duke thënë se nevojitet koordinim institucional edhe me faktorin ndërkombëtar.

PËRMBYLLET UNIVERSITETI VEROR NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS, MORËN PJESË RRETH 350 STUDENTË VENDAS DHE NDËRKOMBËTARË

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në oborrin e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës u zhvillua ceremonia përmbyllëse e edicionit të 26 të Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës (PISU).

Ceremonia nisi me fjalën përshëndetëse të rektorit të Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu. Rektori Hajrullahu falënderoi profesorët dhe studentët ndërkombëtarë e vendas, të cilët me punën, përkushtimin dhe energjinë e tyre e bëjnë të mundur organizimin e përvitshëm të Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës.

Ai tregoi se gjatë karrierës së tij mbi 20-vjeçare si profesor, tri herë kishte pasur kënaqësinë të zhvillonte ligjërata të përbashkëta me profesorë ndërkombëtarë dhe se secila prej këtyre përvojave kishte qenë më e veçantë se tjetra.

Në emër të profesorëve që erdhën nga vende të ndryshme të botës, të pranishmit i



përshëndeti prof. Alain Riveros-Rivera nga Pontificia Universidad Javeriana në Kolumbi.

Duke iu referuar fushës së tij të specializimit dhe kursit për kronobiologjinë dhe mjekësinë e gjumit, të cilin e zhvilloi në Universitetin Veror, ai e përshkroi UP-në jo thjesht si një vend ku informacioni bartet nga profesori te studenti, por si një organizëm i

gjallë, i ndërtuar mbi kureshtjen, dialogun dhe bashkëpunimin. Në emër të profesorëve të UP-së foli profesoresha e Fakultetit të Ekonomisë, Mjellma Carabregu-Vokshi. Ajo e cilësoi Universitetin Veror si shumë më tepër se një program universitar, ndërsa studentët pjesëmarrës si arsyen kryesore të ekzistencës së tij. Gjatë ceremonisë përmbyllëse

folën edhe studenti nga diaspora, Arsim Krasniqi, studenti nga University of Kansas, Solomon Keim, si dhe studentja e Universitetit të Prishtinës, Rela Çelaj, të cilët ndanë përvojat dhe përshtypjet e tyre nga ky edicion. Në fund të ceremonisë, rektori i UP-së, prof. Arben Hajrullahu, u ndau profesorëve dhe profesorëve të UP-së certifikatat e pjesëmarrjes në UVNP. Në edicionin e sivjetmë të Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës morën pjesë rreth 350 studentë vendas dhe ndërkombëtarë. U zhvilluan 19 kurse të bashkëdrejtuara nga profesorë ndërkombëtarë dhe profesorë të UP-së si dhe 12 punëtori. Në kuadër të tyre u trajtuan tema nga inteligjenca artificiale, teknologjia financiare, antropologjia, mjekësia e gjumit, shkencat forenzike dhe fusha të tjera.

Universiteti Veror shënoi edhe 250-vjetorin e pavarësisë së

ShBA-së, solli diskutime për demokracinë dhe të drejtat e grave si dhe vazhdoi traditën e festivalit të filmit të shkurtër UPWard, ku studentët e Fakultetit të Arteve dhe studentët ndërkombëtarë shfaqën filmat e tyre. Studentët e këtij edicioni patën mundësi të dëshmonin edhe shkathhtësi të tyre sportive si dhe të vizitonin vende historike, ta njihnin trashëgiminë kulturore dhe t'i shijonin bukuritë natyrore të Kosovës. Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës është një nga platformat dhe ngjarjet më të rëndësishme për ndërkombëtarizimin, rrjetëzimin dhe shtrirjen globale të UP-së. Përmes tij fuqizohet dhe jetësohet një nga prioritetet kryesore të Universitetit: sjellja e sa më shumë studentëve dhe profesorëve ndërkombëtarë në Prishtinë. Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës mbetet një nga kartolinat më të bukura akademike që Kosova i dërgon botës.

Muja në Istog pas dëmeve nga breshri: Do të propozojmë masa për ndihmë ndaj bujqve

ISTOG, 21 KORRIK - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, ka vizituar të martën fermerët e Istogut të prekur nga breshri, duke premtuar mbështetje për tejkalimin e dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore.

Gjatë vizitës së përbashkët me kryetarin e Istogut, Muja është shprehur se fillimisht duhet të përfundojnë procedurat për

vlerësimin e dëmeve nga komisioni komunal, në mënyrë që raporti të dërgohet për trajtim në institucionet përgjegjëse.

Ai ka bërë me dije se Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve është themeluar nga komuna dhe ka kërkuar që procesi i evidentimit të dëmeve të përfundojë sa më shpejt. "Raporti, pasi të kompletohet, duhet t'i dërgohet Agjencisë për Menaxhim të

Emergjencave, e cila, në bazë të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore, e adreson më pas te qeverisja qendrore", ka deklaruar Muja.

Ministri në detyrë i Bujqësisë ka thënë se, bashkë me zyrtarë të ministrisë, ka parë nga afër gjendjen në terren dhe se nga java e ardhshme do të propozohen masat konkrete për t'u dalë në ndihmë fermerëve të prekur.



KGJK dhe Institucioni i Avokatit të Popullit thellojnë bashkëpunimin institucional

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Rrustem Thaqi, priti në takim Avokatin e Popullit, Naim Qelaj. Gjatë takimit Avokati i Popullit i shprehu urimet e tij kryesuesit Thaqi për marrjen e detyrës, duke i dëshiruar sukses në udhëheqjen e Këshillit

Gjyqësor të Kosovës.

Kryesuesi Thaqi vlerësoi rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke theksuar rëndësinë e bashkërendimit ndërinstitucional për forcimin e sundimit të

ligjit dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe transparent. Qelaj vlerësoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm ndërinstitucional për avancimin e sundimit të ligjit dhe forcimin e sistemit të drejtësisë.

Bashkëbiseduesit diskutuan për çështje me interes të përbashkët që lidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, duke riafirmuar gatishmërinë për forcimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.



NIS SHEMBJA E 11 SHTËPIVE PRANË LIQENIT TË UJMANIT

PRISHTINË, 21 KORRIK - Autoritetet e Kosovës nisën të martën aksionin për shembjen e 11 shtëpive të ndërtuara në pronën e Ndërmarrjes Publike Hidroekonomike "Ibër-Lepenc", në zonën e Liqenit të Ujmanit.

Kryeshefi ekzekutiv i "Ibër-Lepencit", Faruk Mujka, konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se objektet ndodheshin ilegalisht në pronë të ndërmarrjes. Ai tha se pronarëve u ishte kërkuar t'i lironin ato më 3 korrik, por pas moszbatimit të kërkesës, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, nisën zbatimin e vendimit për rrënimin e tyre. "Ne po e kthejmë pronën tonë. Po rrënohen 11 shtëpitë e ndërtuara ilegalisht në pronën e



ndërmarrjes", tha Mujka. "Sipas informacioneve që kemi mbledhur, këto shtëpi, përveç

njëres, janë ndërtuar gjatë viteve 2019/2020", shtoi ai. Policia e Kosovës bëri me dije se

aksioni për asistimin e institucioneve në rrënimin e 11 shtëpive të pushimit pranë

Liqenit të Ujmanit është duke u zhvilluar pa probleme.

Zëvendësudrejtori i Policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha se policia po u ofron mbështetje "Ibër-Lepencit" dhe Ministrisë së Mjedisit në zbatimin e vendimit.

Sipas tij, aksioni ka nisur rreth orës 07:00 në zonën e njohur si "Plazhi i Shqiptarëve", në komunën veriore të Zubin Potokut. "Deri më tani nuk kemi hasur në ndonjë problem për t'u theksuar", deklaroi Elshani për Radion Evropa e Lirë.

Ai konfirmoi se, bazuar në informacionet që ka policia, është paraparë rrënimi i 11 pushimoreve në këtë lokacion. Liqeni i Ujmanit konsiderohet infrastrukturë strategjike për Kosovën, pasi shërben për furnizim me ujë, prodhim të energjisë elektrike dhe ujtitje.

HAXHIU NËNSHKRUAN DEKRETET PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË SHTATË PROKURORËVE SERBË

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka njoftuar të martën se ka nënshkruar dekretet për lirim nga detyra të shtatë prokurorëve nga komuniteti serb të cilët kishin dhënë dorëheqje nga sistemi i drejtësisë në vitin 2022. "Me këtë akt përmbyllet një proces i zgjatur për vite me radhë dhe zbatohet vendimi i institucionit kompetent, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës", shkroi Haxhiu në "Facebook". Këshilli Prokurorial i Kosovës refuzoi më herët këtë javë kërkesën e prokurorëve për

tërheqjen e dorëheqjeve, të paraqitura në nëntor të vitit 2022, kur zyrtarët serbë u larguan kolektivisht nga institucionet e Kosovës në veri të vendit.

Ky vendim u mor me propozimin e nënkryetarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Dardan Vuniqi, ndërsa për të hyrë në fuqi kërkohej dekreti i ushtrueses së detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu. Haxhiu tha se "askush nuk mund të mbajë peng funksionimin e institucioneve" dhe "as të krijojë paqartësi juridike përmes proceseve të papërfunduara". Sipas saj,

Republika e Kosovës "do të vazhdojë të veprojë me vendosmëri, në përputhje me ligjin dhe në mbrojtje të integritetit të institucioneve të saj". Qindra zyrtarë serbë dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022, pasi Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës e mbështetur nga Beogradi - u bëri thirrje përfaqësuesve serbë të largoheshin nga policia, gjyqësori, prokuroria dhe institucionet e tjera në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.



IKShPK: Në Kosovë janë konfirmuar 69 raste me fruth, gjashtë të reja gjatë javës së fundit

PRISHTINË, 21 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë periudhës 16 prill deri më 20 korrik 2026 në Kosovë janë raportuar gjithsej 69 raste të konfirmuara me fruth. Gjatë javës së fundit janë raportuar gjashtë (6) raste të reja me fruth. Sipas komunave, numër më i lartë i rasteve raportohet nga komuna e Prishtinës me njëzetë

e një (21) raste, komuna e Ferizajt me dymbëdhjetë (12) raste, Fushë-Kosova me dymbëdhjetë (12) raste, Kaçaniku me shtatë (7) raste, Lipjani me tri (3) raste, Vushtrria, Shtimja, Drenasi dhe Obiliqi me nga dy raste si dhe me nga një rast komunat Podujevë, Gjilan, Deçan, Skenderaj, Shtërpce dhe Viti.

IKShPK-ja rekomandon që çdo person me simptoma të

dyshimta të fruthit, si temperaturë e lartë, skuqje apo ndryshime në lëkurë, kollë, rrufë ose konjuktivit, të paraqitet menjëherë në institucionet më të afërta shëndetësore.

Duke pasur parasysh infektueshmërinë e lartë të fruthit, rrezikun e përhapjes së tij në komunitet dhe komplikimet që shkakton fruthi, IKShPK-ja u bënë thirrje prindërve dhe

kujdestarëve ta verifikojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe të sigurojnë vaksinimin sipas Kalendarit të rregullt të imunizimit në qendrat e mjekësisë familjare.

Vaksinimi mbetet masa më efektive dhe më e sigurt për parandalimin e fruthit, mbrojtjen e individëve të pavaksinuar dhe ruajtjen e shëndetit publik.



Gërxfaliu: Bllokimi i Hormuzit dhe Bab el-Mandebit do ta trondiste ekonominë botërore

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfaliu, ka paralajmëruar se bllokimi i Ngushticës së Hormuzit dhe Bab el-Mandebit do të kishte pasoja të rënda për ekonominë globale, duke e cilësuar situatën luftë për korridoret tregtare, energjinë dhe rendin e ri botëror. Sipas tij, mbyllja e këtyre dy rrugëve

strategjike detare do të ndikonte në një pjesë të konsiderueshme të tregtisë botërore, do të shkaktoje rritje të çmimeve dhe vonesa të mëdha në zinxhirët globalë të furnizimit. Gërxfaliu thekson se nëse Ngushtica e Hormuzit dhe Bab el-Mandebi do të bllokoheshin njëkohësisht, Kanali i Suezit do ta humbiste funksionin e tij, ndërsa

transporti detar do të detyrohej të devijonte përmes Kepit të Shpresës së Mirë, duke zgjatur udhëtimet me 10 deri në 18 ditë dhe duke rritur kostot e mallrave. Ai shton se, sipas informacioneve mediatike, situata në Hormuz mbetet e paqartë dhe shoqërohet me rreziqe serioze për lundrimin, ndërsa ngre pyetje nëse zhvillimet aktuale mund ta shënojnë fillimin

e një procesi të de-dollarizimit në tregtinë globale dhe një sfide ndaj sistemit të "petrodollarit". Në përfundim, Gërxfaliu vlerëson se Hormuzi dhe Bab el-Mandebi janë shndërruar në nyje kyçe të rivalitetit gjeopolitik, duke ngritur dilema nëse përfituesit më të mëdhenj ekonomikë të kësaj situatë mund të jenë Kina dhe Rusia.



HOTI: NË BRITANI ULEN TAKSAT PËR ENERGJINË, NË KOSOVË QYTETARËT PAGUAJNË MË SHUMË

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ish-kryeministri i Kosovës, deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se qeverisja e mirë nuk matet vetëm me sa të hyra mbledh shteti, por matet me trendin e mirëqenies së qytetarëve. Hoti në një postim në "Facebook" shkruan se me qëllim të zvogëlimit të kostos së jetesës për familje, puna e parë që bëri kryeministri i ri i Mbretërisë së Bashkuar ishte ulja e ngarkesave tatimore në faturat e energjisë, gjersa në Kosovë ndodh e kundërta. "Me qëllim të zvogëlimit të kostos së jetesës për familje, puna e parë që bëri kryeministri i ri i Mbretërisë së Bashkuar ishte ulja e ngarkesave tatimore në

faturat e energjisë. Një masë e tillë është marrë më herët edhe nga disa qeveri të Bashkimit Evropian. Në Kosovë ndodh e kundërta. Jo që nuk janë ulur ngarkesat tatimore në faturat e energjisë, por energjia është shtrenjtuar disa herë. Edhe për naftën, rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare është reflektuar drejtpërdrejt te konsumatori. Meqë TVSH-ja llogaritet mbi çmimin e produktit, sa më i lartë çmimi i naftës, aq më e lartë është edhe shuma e TVSH-së që paguan qytetari. Përmes vendosjes së çmimit maksimal ditor, Qeveria zyrtarisht e ka bartur tek konsumatori i fundit rritjen e çmimit të furnizimit të naftës", ka



shkruar Hoti.

Ai ka thënë se problemi nuk mbaron këtu. "Mosveprimet e qeverisë sot lënë pasoja afatgjata në zhvillimin e gjithmbarshëm njerëzor në Kosovë. Kur çmimet e të mirave elementare, siç janë energjia,

rriten përtej trendit të zakonshëm dhe të pritshëm vjetor, zakonisht familjet i ulin shpenzimet në: arsim, shëndetësi, cilësinë e ushqimit, kulturë e rekreacion. Kjo mund të ketë pasoja të rënda dhe afatgjata, sidomos për fëmijët

dhe familjet me të ardhura të ulëta. Në situata të tilla është jetike roli i shtetit për të parandaluar uljen e konsumit të familjeve për të mira elementare. Një qeveri e përgjegjshme këtë e bën duke marrë përsipër një pjesë të rritjes së kostos së jetesës përmes uljes së ngarkesave tatimore për familje. Ulja e barrës tatimore sot është më e lirë për shtetin sesa kostoja që do të paguajmë nesër për familjet që sot detyrohen të heqin dorë nga shumë nevoja, duke e dëmtuar kështu zhvillimin afatgjatë të anëtarëve të tyre", ka deklaruar Hoti, duke shtuar se qeverisja e mirë nuk matet vetëm me sa të hyra mbledh shteti, por matet me trendin e mirëqenies së qytetarëve.

TREGTIA ME PAKICË SHËNON RITJE NË MAJ, PRODUKTET USHQIMORE ME RITJEN MË TË MADHE

PRISHTINË, 21 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën afatshkurtra të tregtisë me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave për muajin maj 2026. Në muajin maj 2026 indeksi i qarkullimit të tregtisë me pakicë (përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave) kishte rritje për 9,18 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (maj 2025). Sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje të: Tregtisë me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me 22,99 %; Tregtisë me pakicë jo në



dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtisë me Pakicë jo në dyqane (përmes postës ose internetit) me 19,93 %; Tregtisë me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara me 14,02 %; Tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuara me 11,13 %; Tregtisë me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 4,06 %. Në muajin maj indeksi i numrit

të të punësuarve të Tregtisë me Pakicë (përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave) kishte rritje për 2,91 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (maj 2025), sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje të: Tregtisë me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me 10,36 %; Tregtisë me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtisë me Pakicë jo në dyqane (përmes postës ose internetit) me 7,79 %; Tregtisë me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara me 7,33 %; Tregtisë me pakicë e pajisjeve të

tjera shtëpiake në dyqane të specializuara me 7,02 %; Tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuara me 3,55 %; Tregtisë me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 1,95 %. Në muajin maj, indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve të Tregtisë me Pakicë (përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave) kishte rritje për 16,26 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (maj 2025). Sipas aktivitetit ekonomik kishte rritje të: Tregtisë me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me

27,72 %; Tregtisë me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara me 23,23 %; Tregtisë me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara me 20,20 %; Tregtisë me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje dhe Tregtisë me Pakicë jo në dyqane (përmes postës ose internetit) me 16,58 %; Tregtisë me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 16,22 %; Tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuara me 15,83 %; Tregtisë me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara me 12,29 %.

Skema e shtesave për fëmijë mbetet më e madhja, mbi 401 mijë përfitues në qershor

PRISHTINË, 21 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin qershor 2026, sipas të cilave, skema me numrin më të madh të përfituesve mbetet ajo e shtesave për fëmijë. Sipas të dhënave të ASK-së, gjatë muajit qershor 401 786 fëmijë kanë përfituar nga Skema e Shtesave për

Fëmijë, për të cilën janë ndarë 14 551 950.00 euro. Në të njëjtën periudhë, 168 812 persona kanë përfituar nga pensionet bazike të moshës, në një vlerë të pagesave prej 26 968 970.00 euro, ndërsa 47 971 pensionistë kontribuues kanë marrë gjithsej 11 733 751.60 euro. Nga skema për veteranët kanë

përfituar 39 561 persona, me pagesa në vlerë prej 7 838 523.14 euro, ndërsa 12 395 familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës kanë marrë 3 770 279.71 euro. Po ashtu, 15 090 familje kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale, me një vlerë prej 2 255 186.00 euro, ndërsa 21 644 persona me aftësi të kufizuara kanë marrë

pensione në vlerë prej 3 563 995.00 euro. Statistikat përfshijnë edhe pagesat për pensionet familjare, pensionet e Trepçës, pensionet e FSK-së dhe TMK-së, skemën për të verbrit, pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike, kompensimin për punëtorët e arsimit, si dhe mbështetjen financiare për



lehonat e punësuar dhe të papunësuar.

GRUSHTI I DËSHTUAR I CIA-s. KIM PHILBY, HEDHJET ME PARASHUTË DHE ÇFARË NDODHI NË SHQIPËRINË KOMUNISTE

Nga Casey MICHEL

Për dekada me radhë është krijuar një rrëfim i thjeshtë dhe i gatshëm për operacionet e para të fshehta të Perëndimit për të rrëzuar një regjim komunist. Ai tingëllon pak a shumë kështu: gjatë fundit të viteve 1940 dhe fillimit të viteve 1950, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar ndërmorën një seri misionesh të fshehta infiltrimi në Shqipëri, duke hedhur me parashutë agentë që synonin përmbysjen e qeverisë së Enver Hoxhës.

Operacioni, megjithatë, përfundoi në një dështim spektakolar, pothuajse legjendar, sepse oficeri britanik i inteligjencës Kim Philby, ndoshta agjenti i dyfishtë më famëkeq i Bashkimit Sovjetik, informoi drejtuesit e tij në Moskë, të cilët nga ana e tyre paralajmëruan aleatët në Tiranë.

Dekada më vonë, ky rrëfim ruan ende disa elemente të së vërtetës. Po, pati hedhje me parashutë në Shqipëri gjatë viteve të para të Luftës së Ftohtë. Dhe po, operacioni ishte një bashkëpunim anglo-amerikan. Por, siç argumenton politologu Stephen Long në librin e tij të ri "A Rich Harvest of Bitter Fruit", pothuajse gjithçka tjetër në këtë histori është e gabuar. Falë kërkimeve në arkiva dhe dhjetëra intervistave, Long zbuloi se këto misione nuk kishin domosdoshmërisht për synim rrëzimin e Hoxhës apo fundin e komunizmit në Shqipëri. Dhe, në korrigjimin ndoshta më të rëndësishëm të kësaj historie, ai shkruan se Philby dhe Bashkimi Sovjetik mund të mos kenë pasur asnjë rol në dështimin përfundimtar të operacionit.

Duke e çliruar këtë mision nga mjegulla e miteve historike, Long ka nxjerrë në dritë një kapitull të historisë së hershme të Luftës së Ftohtë, shumë më të trazuar dhe katastrofik sesa është menduar deri sot. Dhe është një histori që fiton një rëndësi të re pikërisht tani, ndërsa Shtetet e Bashkuara po shqyrtojnë sërish mundësinë e ndryshimit të regjimeve, këtë herë në Iran, Kubë dhe vende të tjera.

Kur Enver Hoxha mori pushtetin në ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u shndërrua në një vend të përcarë. Kjo nuk vlente vetëm për opozitën anti-Hoxha, e cila përfshinte nga forca pro-monarkiste te grupime pro-perëndimore dhe mbështetës të lidhjeve më të ngushta me komunistët jugosllavë. Përçarje kishte edhe brenda vetë regjimit të Hoxhës. Spastrime, arrestime, gjyqe spektakolare dhe dënime të montuara: vitet e para të Hoxhës panë diktatorin në ngjitje të godiste njësoj miq dhe armiq. Kjo krijoi përshtypjen, të paktën për vëzhguesit e jashtëm, se Shqipëria ishte një "vend në kaos", siç shkruan Long, që priste vetëm serinë e duhur të ngjarjeve për ta parë qeverinë të shembej. Në skenë hynë shërbimet amerikane dhe britanike të inteligjencës së pasluftës. Shumë larg imazhit të organizuar dhe

burokratik të spiunazhit të Luftës së Ftohtë të mëvonshme, MI6 dhe CIA e viteve të para ishin pothuajse një grup i çorganizuar. Me pak mbikëqyrje, veçanërisht nga ana amerikane, këto agjenci mund të hartonin çfarëdo plani apo skeme që u shkonte ndër mend. Duke lexuar librin e Long-ut, krijohet përshtypja se ata ngjanin më pak me James Bond-in dhe më shumë me personazhet e Monty Python-it. Kjo qasje mund të kishte qenë qesharake, po të mos kishte sjellë kaq shumë vdekje dhe shpërdorim burimesh.

Ndërsa vëzhgonin Shqipërinë nga larg, zyrtarët amerikanë dhe britanikë kuptuan se kishin nevojë për një pasqyrë më të qartë të asaj që po ndodhte brenda vendit. Ideja për një mision në Shqipëri nuk ishte domosdoshmërisht rrëzimi i Hoxhës; nëse diktatori shqiptar do të binte, Londra dhe Uashingtoni shqetësoheshin jo vetëm për reagimin sovjetik, por edhe për mundësinë që fqinjët e Shqipërisë, Italia, Greqia dhe Jugosllavia, ta copëtonin vendin. Për këtë arsye, misioni kishte për qëllim të vlerësonte se sa i brishtë ishte në të vërtetë regjimi i Hoxhës dhe të përcaktonte hapat që duhej të ndiqeshin më pas.

Për të mbledhur informacion, zyrtarët britanikë dhe amerikanë hartuan një plan që, të paktën në letër, duhej të destinuar për sukses. Ata rekrutuan dhjetëra emigrantë shqiptarë të shpërndarë në kampet e refugjatëve në Europë dhe i trajnuan në Maltë dhe Gjermaninë Perëndimore për gjithçka, nga përdorimi i armëve të lehta e deri te leximi i hartave dhe "arti i vrasjes në heshtje". Fillimisht, britanikët organizuan një seri zbarkimesh të fshehta nga deti; më vonë, në misionet ajrore të drejtuara nga amerikanët, një ekuipazh polak pilotonte një avion C-47 pa shenja identifikuese në hapësirën ajrore shqiptare, prej nga agjentët hidhnin me parashutë në territorin shqiptar. Pasi të zbrisnin, këto ekupe shqiptare duhej të transmetonin me radio vlerësimet e tyre, të siguronin mbështetje në terren dhe të prisnin udhëzime të mëtejshme.

Megjithatë, pothuajse që në fillim, gjithçka nisi të shkonte keq. Gati gjysma e agjentëve shqiptarë të planifikuar për hedhjen e parë me parashutë në vitin 1950 u tërhoqën, thuhet për shkak të "përplasjeve politike" mes tyre. Edhe me grupin e reduktuar, misioni u anulua për shkak të shiut dhe dëborës së dendur. Rreth një javë më vonë, kur zyrtarët amerikanë vendosën ta provonin sërish, vetë agjentët mbanin robra aq të holla, "krejtësisht të papërshtatshme për kushtet jashtëzakonisht të ftohta dhe të lagështa të dimrit", shkruan Long, sa që disa prej tyre "u detyruan të prisnin parashutat e vogla rezervë për t'i mbështjellë rreth trupit dhe për t'u ngrohur." Prej aty, gjërat vetëm sa u përkeqësuan. Ekuipazhi polak i avionit i hodhi agjentët një ditë të tërë larg ecjeje nga vendi ku duhej të



zbarkonin. Çdo element i fshehtësisë u zhduk menjëherë. Siç kujtonte një prej agjentëve: "Të gjithë e morën vesh se kishin zbritur parashutistë, sepse pajisjet tona ranë në një fshat aty pranë."

Agjentët u fshehën në një pyll për gati një javë për t'iu shmangur kontrolleve të forcave të sigurisë komuniste. Kur më në fund dolën, banorët vendas u treguan se forcat e sigurimit shqiptar kishin përgatitur një pritje në zonën ku ishte planifikuar fillimisht hedhja. Kjo do të thoshte se gabimi në vendin e zbarkimit, paradoksalisht, ua kishte shpëtuar jetën.

Pa furnizime dhe pa asnjë element surprize, agjentët e braktisën plotësisht misionin dhe u tërhoqën në këmbë drejt kufirit jugosllav, ku arritën të shpëtonin. Ky model do të përsëritej vazhdimisht.

Një agjent që mori pjesë në një mision të mëvonshëm kujtonte se ekipi i tij kishte gabuar zonën e hedhjes me rreth pesë kilometra e gjysmë. Menjëherë pasi prekën tokën, zbuluan se drejtuesi i misionit ishte "i dehur nga uiski që ishte menduar t'i qetësonte nervat para nisjes."

Duke u endur drejt fshatit më të afërt, ata u detyruan të fshiheshin sërish nga forcat e sigurisë, duke mbijetuar për dy javë pothuajse vetëm me misër të papjekur. Ashtu si grupi i parë, e vetmja rrugë shpëtimi ishte kalimi i kufirit. Më në fund ia dolën të arratiseshin në Greqi.

Dhe këta ishin fatlumët. Ekip pas ekipi u zhduk menjëherë pas hedhjes me parashutë, pa u dëgjuar më kurrë nga drejtuesit amerikanë dhe britanikë. Brenda pak vitesh humbën dhjetëra agjentë.

Siç dokumenton Long, forcat shqiptare të sigurisë kishin një avantazh vendimtar: ato dinin saktësisht se ku ndodheshin zonat e hedhjes, shumë kohë përpara se ekipet të niseshin. Shumë shpesh, rekrutët shqiptarë hidheshin me parashutë drejt e në vdekje.

Vit pas viti, rezultatet mbetën të njëjtat. Shumë pak informacion arrinte në Uashington dhe Londër, ndërsa ekupe të tëra shqiptarësh antikomunistë zhdukeshin pa lënë gjurmë.

Siç dokumenton Long, operacioni gjashtëvjeçar, i cili përfundoi në vitin 1955, pati një normë humbesh prej 36 për qind, një shifër tronditëse, si për atë kohë ashtu edhe për standardet e

sotme.

Ndërkohë, Enver Hoxha mbeti në krye të regjimit edhe për shumë dekada, duke vdekur në vitin 1985 si një nga udhëheqësit komunistë më jetëgjatë në histori.

Libri A Rich Harvest of Bitter Fruit i rrëfen këto dështime me një nivel jashtëzakonisht të hollësishëm. Duke analizuar me imtësi gjithçka – nga rekrutimi i agjentëve deri te tensionet burokratike mes Londrës dhe Uashingtonit – libri përbën një studim të jashtëzakonshëm mbi një operacion që për një kohë të gjatë i kishte shpëtuar vëmendjes së historianëve.

Dhe pikërisht mbi këtë bazë ndërtohet zbulimi më i rëndësishëm i gjithë librit.

Siç përfundon Long, ideja se i gjithë operacioni u sabotua nga Kim Philby dhe drejtuesit e tij sovjetikë është e rreme. Madje, kjo teori ka shërbyer për të shmangur përgjegjësinë si të agjentëve përndimorë, ashtu edhe të vetë emigrantëve shqiptarë.

Në fund të fundit, Shqipëria ishte një periferi gjeopolitike. Ishte një shtet satelit i Bashkimit Sovjetik, por vështirë se përbënte një interes thelbësor për Moskën, aq sa kjo të rrezikonte agjentin e saj më të vlefshëm.

Siç kujtonte një zyrtar amerikan: "Pse do të rrezikonte dikush që është në mendjen e tij një aset si Philby për një qëllim të tillë?" Edhe vetë Philby, sipas Long-ut, duhet të ketë arritur në të njëjtin përfundim. "E thënë thjesht, Shqipëria nuk ia vlente të rrezikojë lëkurën për të," shkruan ai.

Sipas Long-ut, dështimi spektakolar i operacionit kishte dy fajtorë kryesorë. I pari ishin vetë rekrutët shqiptarë. Pavarësisht gjithë stërvitjes që kishin marrë, ata ishin larg të qenit njësi të mirëfillta të operacioneve të fshehta. Disa prej tyre, sipas një raporti, "nuk arrinin të dallonin një tank nga një traktor bujqësor", ndërsa shumë të tjerë nuk arrinin ta mbanin sekret misionin që kishin marrë për-sipër, veçanërisht brenda komunitetit të emigrantëve shqiptarë.

Ky lloj muhabeti i pakujdesshëm, që një zyrtar amerikan e quajti "biseda nëpër bare", përfundonte shumë shpejt në veshët e autoriteteve komuniste. Duke qenë se agjentët shqiptarë shpesh hidheshin me parashutë pranë fshatrave ku ishin rritur, nuk duhej shumë punë hetimore që Tirana të kuptonte se ku do të zhvillohej misioni i radhës.

Por problemi nuk ishin vetëm shqiptarët. Edhe oficerët e CIA-s që drejtonin operacionin ishin larg standardeve profesionale të një shërbimi sekret.

Një prej tyre kujtonte më vonë: "Disa nga kolegët e mi ishin aq të zhurmshtë, sa ishte njësoj si të përpiqesh të fshihje Katedralen e Shën Pjetrit dhe ta quaje operacion sekret."

Një vetëbesim i tepruar përshkonte të gjithë misionin, duke i verbuar oficerët e CIA-s ndaj faktit se kundërshtarët shqiptarë kishin fituar epërsi.

Në një rast, kur një ekip shqiptar nuk arriti shtatë herë radhazi t'i

përgjigjej saktë një pyetjeje kontrolli të CIA-s – procedurë që shërbente për të vërtetuar nëse agjentët ishin ende të lirë – drejtuesit amerikanë vazhduan të silleshin sikur gjithçka ishte normale, pa kuptuar se ekipi ishte kapur.

Siç shkruan Long, ata "ngurronin të pranonin se ekipi i tyre më i çmuar i agjentëve kishte rënë në duart e armikut."

Me kalimin e kohës amerikanët filluan të dyshonin për atë çfarë kishte ndodhur. Por, në vend që ta pezullonin operacionin, vazhduan të hidhnin ekupe të reja agjentësh drejt e në grackën e autoriteteve shqiptare, duke e shndërruar atë që fillimisht ishte vetëm "një pengesë e përkohshme" në "një katastrofë të pakthyeshme."

Falë punës së Stephen Long-ut, kjo katastrofë e pakthyeshme më në fund ka një pasqyrë historike shumë më të saktë.

Nëse rasti i Shqipërisë është një tregues, atëherë shumë nga ato që besohet se dihen për operacione të ngjashme amerikane në Bullgari, Rumani, Poloni apo Ukrainë mund të rezultojnë po aq të gabuara pas një shqyrtimi më të kujdesshëm – aq më tepër që edhe për dështimin e tyre shpesh është fajësuar Kim Philby.

Deri atëherë, një gjë mbetet e qartë: të vetmit që korrrën "frytet e hidhura" të këtij operacioni ishin zyrtarët në Londër dhe Uashington, si edhe forcat shqiptare antikomuniste që mbetën të bllokuara në mes.


Ky është një mësim që zyrtarët amerikanë do të bënin mirë ta kishin parasysh edhe në vitin 2026, sidomos pas luftës katastrofike në Iran. Në fund të fundit, edhe regjimi në Teheran duhej, të paktën nga jashtë, sikur ishte pranë rrëzimit vetëm pak muaj më parë. Megjithatë, ai jo vetëm që mbijetoi, por në një farë mënyre doli edhe më i fortë.

Ajatollahët mund të kenë shumë pak të përbashkëta me Enver Hoxhën, por të dyja regjimet rezultuan shumë më të qëndrueshme sesa kishte parashikuar Uashingtoni.

Ironikisht, ishte vetë CIA ajo që këtë herë duhej se e kishte kuptuar këtë realitet. Në prag të luftës, drejtori i CIA-s, John Ratcliffe, i kishte cilësuar përpjekjet për ndryshim regjimi në Iran si "qesharake".

Ratcliffe, në fund, rezultoi se kishte pasur të drejtë. Megjithatë, paralajmërimet e tij kishin pak peshë përballë një administrate të bindur se rruga që kishte zgjedhur do ta çonte drejt fitores. Ashtu si në Shqipëri, katastrofa në Iran nuk ishte pasojë e ndonjë spiuni të infiltruar apo e ndonjë tradhtari të fshehtë. Ishte thjesht rezultat i një administrate amerikane që ishte bërë viktimë e arrogancës së vet.

Drejtues i Programit p'r Lu kund'r Kleptokracis° n° Huma Rights Foundation dhe autor i rit American Kleptocracy: the U.S. Created the World's Greatest Money Laundering Scheme in History . / Fore Policy Bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kumbulla do të kthehet në La Liga

ROMË, 21 KORRIK - Mbrojtësi shqiptar Marash Kumbulla pritet që karrierën ta vazhdojë në La Liga të Spanjës, pasi nuk bën pjesë në planet e skuadrës së Romës. Pas huazimit të Mallorca, Kumbulla është kthyer te

Roma, por skuadra italiane po kërkon një klub të ri për futbollistin e Kombëtares së Shqipërisë. Dhe gjasat janë të mëdha që Kumbulla edhe sezonin e ardhshëm të luajë në elitën e futbollit spanjoll pasi tri skuadra kanë shprehur

interesim për shërbimet e tij. Rayo Vallecano, Elche dhe Levante po synojnë transferimin e Kumbullës gjatë kësaj vere dhe Roma është e gatshme ta pranojë ofertën për shitjen e 26-vjeçarit.

Kumbulla ka kontratë me Romën deri në vitin 2028, kurse kartoni i tij vlerësohet rreth 3 milionë euro. Krahas Romës dhe Mallorcas, Kumbulla gjatë karrierës ka luajtur edhe tek Espanyoli, Sassuolo e Verona.



RENDITJA E RE E FIFA-s PAS KUPËS SË BOTËS: SPANJA NGJITET NË KRYE, MAROKU HYN NË HISTORI

ZYRIH, 21 KORRIK - Kampionia e botës, Spanja, ngjitet në vendin e parë të renditjes me 1995.88 pikë, ndërsa Norvegjia dhe Tunizia regjistrojnë lëvizjet më të mëdha në klasifikimin e ri. FIFA ka publikuar renditjen më të re botërore të kombëtareve pas përfundimit të Kupës së Botës 2026, me Spanjën që ka marrë zyrtarisht kreun e klasifikimit. Triumfi në Botërori i ka siguruar "La Rojas" vendin e parë në botë, duke zbritur Argentinën në pozitën e dytë. Spanja kryeson renditjen e re të FIFA-s me 1995.88 pikë, duke u bërë kombëtarja me më së shumti pikë në botë. Përveç vendit të

parë, kampionët e botës ishin edhe përfituesit më të mëdhenj të këtij përditësimi, pasi fituan 121.17 pikë, më shumë se çdo kombëtare tjetër. Pas Spanjës renditen Argjentina në vendin e dytë, Franca në të tretin, Anglia në të katërtin dhe Brazili në pozitën e pestë. Maroku ngjitet në vendin e gjashtë, duke regjistruar renditjen më të lartë në historinë e tij, ndërsa dhjetëshja e parë plotësohet nga Portugalia, Belgjika, Holanda dhe Meksika. Përveç ndryshimeve në krye të renditjes, FIFA ka publikuar edhe statistikën më të spikatura të përditësimi. Norvegjia është



kombëtarja me ngritjen më të madhe, duke fituar 12 pozita,

ndërsa Tunizia ka pësuar rënien më të madhe, duke zbritur 12

vende. Në aspektin e pikëve, Panamaja ishte kombëtarja që humbi më së shumti, me një rënie prej 60.74 pikësh, duke u bërë skuadra më e goditur në klasifikimin e ri.

Ndërsa Kosova nuk ka lëvizur vendi, gjendet në vendin e 78, njëjtë si në renditjen e kaluar, kurse Shqipëria e ka humbur një pozitë dhe tani është në vendin e 66.

Renditja e re pasqyron ndikimin e Kupës së Botës 2026 në futbollin ndërkombëtar, me Spanjën që rikthehet në majën e hierarkisë botërore dhe disa kombëtare që shënuan lëvizje historike falë paraqitjeve të tyre në turne.

GRANIT XHAKA, ME REKORD UNIK NË KUPËN E BOTËS

BERNË, 21 KORRIK - Kapiteni i Kombëtares së Zvicrës, Granit Xhaka, ka lënë gjurmë në Kupën e Botës 2026, turne që u mbajt në ShBA, Meksikë dhe Kanada. Në fakt, Xhaka dhe Dayot Upamecano i Francës e kanë mbyllur Botërorin si dy futbollistët që e kanë kthyer posedimin e topit më së shumti për kombëtares të tyre. Xhaka dhe Upamecano kanë regjistruar nga 44 raste të rikthimit të posedimit të topit, duke ndarë së bashku vendin e parë në këtë statistikë të turneut, i cili përfundoi të dielën mbrëma. Mesfushori shqiptar ishte lider i Zvicrës dhe më i merituari që



"Helvetikët" kanë arritur deri në çerekfinale të Botërorit, ku janë eliminuar nga Argjentina pas vazhdimëve. Në Botërorin 2026, Xhaka ka regjistruar 6 paraqitje, apo në total 600 minuta lojë, ku

ka shënuar një gol dhe ka pasur gati 400 pasime të sakta. Për Xhakën, ky ishte Botërori i katërt me Zvicrën, duke barazuar rekordin me Xherdan Shaqirin dhe Valon Behramin.

ZIDANE ZËVENDËSON DESCHAMPSIN TE FRANCA

PARIS, 21 KORRIK - Legjenda Zinedine Zidane do ta drejtojë kombëtaren e Francës në futboll deri në verën e vitit 2030. Prej kohësh është pritur që Zidane ta zëvendësojë Didier Deschampsin te Franca, dhe tashmë kjo është bërë realitet, kanë njoftuar mediet franceze. Marrëveshja në mes të Zidanet dhe federatës franceze tashmë është arritur, ndërsa ka mbetur vetëm prezantimi i ish-mesfushorit të Real Madridit. Fokusi i Zidanet si selektor i Francës, do të jetë Evropiani i vitit 2028 dhe Kupa e Botës 2030. Franca ishte favorite për triumf në Botërorin e këtij viti, por u ndal në gjysmëfinale nga Spanja, kombëtare që u shpall



kampione e botës. Zidane ka shkruar histori si lojtar me Francën, ndërsa si trajner ka punuar vetëm te Real Madridi, skuadër me të cilën nuk i kanë munguar sukseset. 54-vjeçari si lojtar ka regjistruar 108 ndeshje për Francën si dhe ka shënuar 31 gola me fanellën e "Gjelave".

Bayerni, Realit: Olise nuk është në shitje!

BAYERN, 21 KORRIK - Bayern Munich nuk ka ndër mend të heqë dorë nga Michael Olise pavarësisht prej interesimit në rritje të Real Madridit për sulmuesin francez. Sipas AS, kampionët e Bundesligës e konsiderojnë 24-vjeçarin pjesë kyçe të projektit të tyre dhe nuk e kanë nxjerrë në shitje.

Si sinjal i qartë për të ardhmen e tij, klubi bavarez e ka vendosur Olisen në qendër të fushatës promovuese të fanellës së re mysafire, duke lënë të kuptohet se ai mbetet një nga figurat kryesore të skuadrës. Megjithatë, Real Madridi vazhdon ta ndjekë me vëmendje situatën e

reprezentuesit francez, i cili ka spikatur me paraqitjet e tij në Kupën e Botës 2026. Drejtuesit e klubit spanjoll e shohin Olisen si një përforsim ideal për repartin ofensiv. Megjithatë, Real Madridi nuk pritet të bëjë hapa konkretë pa marrë fillimisht një sinjal të qartë nga Olise se dëshiron të

largohet nga Bayern Munich. Olise iu bashkua Bayernit në vitin 2025 dhe, brenda një kohe të shkurtër, është shndërruar në një nga lojtarët më të rëndësishëm të skuadrës bavareze. Për këtë arsye, çdo klub që synon transferimin e tij duhet të përballet me një kërkesë të lartë financiare, pasi Bayerni



e vlerëson shumë kartonin e francezit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RING-A” Sh.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810972655 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RING-A” D.O.O. od Prizren, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810972655 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “RING-A” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 810972655 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Prishtinë, 20.07.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „ARIANI COMPANY“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 811106972 me adresë: Rr. „Dëshmorët e Kombit“, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 02.07.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **1.2 MW** ZK Vërmicë, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës.

Shoqëria „ARIANI COMPANY“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **1.2 MW** ZK Vërmicë, Komuna e Vushtrrisë, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.5856-2/25 dt. 05.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 08 Nr. 31/26 dt. 04.02.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimi për Leje Ndërtimore, numri i vrojtimit i lejes: 80/26 dt. 24.03.2026 për “Vendosjen e Paneleve Solare Fotovoltaik-Gjenerator Fotovoltaik me kapacitet 1.2 MW, ngastra katastrale 2177K-0 ZK Vërmicë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 5718 dt. 22.04.2025 të lëshuar nga KEDS S.H.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: arben.lubishtani@elen-ks.com fnisnik.rudari@elen-ks.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Tafingo” L.L.C. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811481697 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Tafingo” D.O.O. od Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811481697 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Tafingo” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 811481697 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Merita Dajaku shpall të pavlefshme diplomën e SHMLM Dr. Xheladin Deda.

- ODON LLC nga Gjakova, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK Identifikues: 812316059, të lëshuar nga ARBK.

- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl. 6-9 të sh.m.u. “Rudolf Walther” Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Adizo SH.PK. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

